


REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No 01-3911/13
Nr. llog. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 15.11.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.11.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2429/13, për z. Fikri Vërbani – Drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në Komunën e Kaçanikut, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2429/13, për zyrtarin e lartë z. Fikri Vërbani – Drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në Komunën e Kaçanikut, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.SH.T. “RI-ECODEX” dhe pronar në Ndërmarrjen Tregtare Shërbyese “ECODEX”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Vërbani fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim, ai ka konfirmuar se ushtron pozitën e Drejtorit të Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në Komunën e Kaçanikut, dhe njëkohësisht është person i autorizuar respektivisht pronar në bizneset e lartpërmendura.

Pasi që ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, ai ka premtuar se në afatin ligjor do ta autorizoj një person të besueshëm që ta udhëheq kompaninë (N.SH.T. "RI-ECODEX") ndërsa për Ndërmarrjen "ECODEX" do të filloj procedurën e shuarjes.

Pas kësaj, z. Vërbani, ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve (DPKI 03-2920/13 dhe DPKI 03-3674/13 dhe) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka bërë ndryshimet e premtuara.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore e Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

